REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br: 44/17
Datë/Datum: 22.02.2017
PRISHTINË • PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova –Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	44/17
PËR:	- Zyrtarit të prokurimit të AK-së,Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit - Parashtruesit të ankesës : "Besi"Prishtinë
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Agim Sheqiri, Ekspert Shqyrtues i Prokurimit
TEMA:	Raport i vlerësimit për tenderin "MIREMBAJTJA DHE SERVISIMI I AUTOMJETEVE TË MKRS-së me nr. prok. 207-16-015-221 - të realizuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	22.02.2017

Bazuar në nenin 114 të LPP- së ju njoftojmë me ekspertizën për ankesën e parashtruar nga OE. "Besi" lidhur me aktivitetin e prokurimit "MIREMBAJTJA DHE SERVISIMI I AUTOMJETEVE TË MKRS-së me nr. prok. 207-16-015-221 - të realizuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit

Autoriteti Kontraktues dhe OE ankues është i thirrur që pas marrjes së raportit të Ekspertit Shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësishtë pretendimeve të bëra në ankesë me numer 44/17 të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Të bashkangjitur gjeni raportin e Ekspertit Shqyrtues.`

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES

		15.02.2017		21.02.2017		22.02.2017
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të eksp.		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit

Neni 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datë 10.02.2016 Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE. "Besi" Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit "MIREMBAJTJA DHE SERVISIMI I AUTOMJETEVE TË MKRS-së me nr. prok. 207-16-015-221 - të realizuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit

Konform nenit 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues : OE. " Besi" Prishtinë

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 1-Qëllimi pika 1 dhe 2 Neni 59-Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve i LPP Neni 61- Tenderët Jo-Normalisht të Ulët B57- Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Nenin 2 dhe nenin 3 te Vendimit te OSHP-se Nr.396/16 te dates22/12/2016

Rregullat dhe udhëzuesi operativ i prokurimit publikë pika 25.

I pakënaqur ne Vendimin e AK nr. 5235/2016 te datës 01/11/2016 me arsyetim se ankesa është e pabazuar ne afatin e lejuar ushtroje ketë ANKESE te vendimin per shkak

Konstatimit te gabuar te gjendjes faktike

Aplikimit te gabuar te te drejtës materiale.

A r sy e ti m.-Me datën 18/01/2016 kemi pranuar nga ana AK Letrën Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm për projektin MIREMBAJTJA DHE SERVISIMI I AUTOMJETEVE TE MKRS-së, Nr.prok. 207-16-015-221 me arsyetim se kontrata i është dhënë Operatorit Ekonomik: dipz"SUZUKI", Fushë Kosovë. Duke pare qe AK nuk e ka zbatuar Vendimin OSHP-se nr.396/16 te datës 22/12/2016 gjegjësisht piken 2 këtij vendimi qe ka qene te anulohet Vendimi për dhënie te kontratës OE Suzuki dhe lënda prapë te kthehet ne rivlerësim AK prapë e shpalle fitues te njëjtin OE Suzuki. Si duket dhe ne baze te vendimit qe kanë marr ata janë mbi ligjin pasi nuk I njohin vendimet e OSHP-se.

Pas kërkesës per rishqyrtim te datës 24/01/2017 me datën 31/01/2017 nga AK vjen Vendimi nga AK mbi refuzimin e ankesës se parashtruar. Bazuar ne rrjedhjen e kësaj procedure te prokurimit vërejmë qe kjo procedure e prokurimit nuk është zhvilluar sipas parimeve baze te prokurimit, pasi të gjitha

aktivitetet e prokurimit duhet të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike: Konkurrenca, Efikasiteti& Efektiviteti, Drejtësia/Mos-diskriminimi,Objektivitet/Integritet/Sinqeritet — Transparenca Llogaridhënie - Profesionalizëm. Kjo procedure ka filluar gati qe një vit dhe tri here është anuluar me dt.22/03/2016, me datën 31/05/2016 mandej me datën 01/08/2016 dhe akoma kjo procedure është ne vlerësim. Kete procedure te prokurimit e ka përcjellë neglizhenca si dhe subjektivizmi i zyrtarit përgjegjës te prokurimit pran AK sa qe dyshojmë edhe ne elemente korruptive, dhe njerëzit te cilit punojnë me inate dhe teke nuk e kanë vendin ne vende te tilla siç është prokurimi. Kjo e dëshmon me faktin se edhe ne seancën e mbajtur për ketë projekt zyrtari përgjegjës ka marr vendim pa u bazuar ne shqetësimet e anëtarëve te komisionit për çmime jo normale ku zyrtari përgjegjës ne baze te kompetencave qe i ka i ka pranuar arsyetimet e OE te rekomanduar për kontrate vetëm e vetëm qe ky OE te shpërblehet mos te shpallet i papërgjegjshm pasi inati i tij ka qene qe mos te vimi ne si kompani ne shprehje per shpërblim me kontrate. Me datën 31/01/2017 ne pranojmë Vendimin e AK pas kërkesës për rishqyrtim te Vendimit dhe AK e refuzon si te pa baze duke na shpalle te papërgjegjshëm. Tani parashtrohet pyetja se si është e mundur qe dy here nga AK kemi pranuar letrën standarde per tenderuesin e pasuksesshëm mandej edhe një here kërkesën për rishqyrtim si tenderues i pasuksesshëm tani vjen vendimi nga AK dhe na shpalle te papërgjegjshëm. Me datën 31/08/2018 një operator ekonomik paska parashtruar një kërkesë për informata shtese dhe atë:"Vendndodhja jo me larg se 20 km prej Prishtinës, ose marrëveshje me ndonjë servis te rregullt dhe Vendndodhja jo me larg se 15 km prej Prishtinës, ose marrëveshje me ndonjë servis te rregullt. Cila është e vlefshme pasi ne tenderin qe është anuluar ka qene 20 km.dhe me profesionalizem zyra e prokurimit e pranon ate kerkese per informata shtese pasi ne menyre decidive ne DT ka shkruar per Dëshmia e kërkuar dokumentare – "Vendndodhja jo me larg se 15km prej Prishtinës, ose marrëveshje me ndonjë servis te rregullte./foto/deshmi/shkrese"si dhe per adrese te kompanise.

Kjo pyje është bere pas afatit per parashtrimin e kërkesave per informata shtese pasi afati i fundit ka qene data 29/08/2016 ora 15.00.

Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit operativ Neni 25. - Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore alinea 25.2 Një kërkesë e tillë me shkrim duhet të dërgohet në mënyrë elektronike dhe duhet të pranohet nga AK brenda afatit kohorë të specifikuar në DT. Nëse kërkesa për sqarime pranohet pas ditës së fundit të paraparë për sqarime, kërkesa e tille refuzohet dhe OE do të informohet për arsyen e refuzimit. Një kërkese e dorëzuar pas afatit te parapare për sqarime mund te shqyrtohet dhe nëse

Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues - Me 2510.2016 është nënshkruar deklarata e nevojave dhe disponueshmerise se mjeteve me për ketë aktivitetit të prokurimit, ndërsa me datë 22.08.2016 është dorëzuar njoftim për publikim ne KRPP .

Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-36) –Procedure e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar- Kontratë për shërbime me vlerë te mesme , vlera e parashikuar është : LOTI I 60,000.00€
LOTI II 40,000.00€

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: Afati për pranim te ofertave është data ka qenë data 28.03.2016 por është shtyrë deri me datë 05.09.2016

Njoftimi për dhënie te kontratës: Me date 20.01.2017 është berë njoftim për dhënie të kontratës

Kriteret e përzgjedhjes

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit – origjinal ose kopje e vërtetuar (vetëm për operatorin ekonomik përfitues të kontratës);
3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente qe vërteton se operatori ekonomik i përmbush ''Kërkesat e përshtatshmërisë''për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nënparagrafi 4.1, 42 dhe 4.4, kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo me e vjetër se 30 dite nga data e dorëzimit te tenderit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nen betim – kërkohet origjinal
2. Vërtetim nga ATK – kërkohet kopje
3. Vërtetimi nga Gjykata Ekonomike kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar

Dokumentet(nen 2 dhe 3) duhet te dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit te dhënies se kontratës. Ne rast te dështimit te dorëzimit te dokumenteve te tilla, tenderi ne fjale do te refuzohet dhe Autoriteti kontraktues do te vazhdoje me tenderuesin e radhës

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Ne mënyre qe te dështmohet se operatori ekonomik është i përshtatshëm, duhet t'i dorëzoje regjistrimin si operator ekonomik ne regjistrin profesional , komercial dhe \ose te korporatës ne shtetin e themelimit te operatorit ekonomik.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Certifikata e regjistrimit te biznesit(kopje)
2. Certifikata e TVSH-se(kopje)
3. Certifikata e Numrit Fiskal (kopje)

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Një listë që specifikon parimet relevante të performancës që specifikon: shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin gjatë tri viteve të fundit (2013, 2014, 2015),
2. Automjet për bartjen- tërheqjen e automjeteve në defekt,
3. Hapësirë dhe kushte të mjaftueshme të objektit për servisim të veturave, minimum 250m^2
4. Të ketë së paku 3 vinça për ngritje të automjeteve,
5. Aparatin për mbushjen e klimave,
6. Të posedojë pajisjen për diagnostifikim të defekteve të automjetit,
7. Dëshmi mbi stafin e punësuar – serviserve për servisim të automjeteve – kërkohet :
   - Së paku (1) auto ngjyresës,
   - Së paku (1) auto mekanik,
   - Së paku (1) auto elektricist,
8. Pajisje për riparimin dhe ballansimin e gomave
9. Pajisje për centrimin e trapit-Regllazhes ose marrëveshje me ndonjë servis për huazimin e pajisjes
10. Vendndodhja jo me larg se 20km prej Prishtines ose marrëveshje me ndonjë servis te rregullte

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e kontratave paraprake , duke saktësuar – shërbimet e kryera , shumat , vendin , datën dhe pranuesin e shërbimeve me min 2 referenca përkatëse– (origjinal).
2. Të dëshmohet me libreze për regjistrimin e automjetit dhe fotografi.
3. Hapësira në punishte të jetë e mbrojtur nga ndikimet atmosferike siç janë; shiu, bora, pluhuri, etj, minimum 250m^2 të dëshmohet me fotografi të kjarta.
4. Të dëshmohet me foto.
5. Të dëshmohet me foto.
6. Të dëshmohet me foto.
7. Listën e stafit – serviserve për servisim të automjeteve – kërkohet:
   - Së paku (1) auto ngjyresës,
   - Së paku (1) auto mekanik,
   - Së paku (1) auto elektricist,

Duhet të posedojnë certifikata përkatëse të kualifikimit ose shkollimit dhe të dëshmohet se janë punëtor të rregullt të kompanisë) me këto dokumente:
Deklarate e nënshkruar për stafin e punësuar te kompanisë- kërkohet kopje,
Certifikata përkatëse e kualifikimit ose shkollimit në fushën përkatëse – kërkohet origjinal ose kopje e noterizuar

8. Të dëshmohet me foto.
9. Të dëshmohet me foto. ose marrëveshje me ndonje servis per huazimin e pajisjes
10. Vendndodhja jo me larg se 20km prej Prishtinës, ose marrëveshje me ndonjë servis te rregullte./foto/dëshmi/shkrese

Vërejtje :

Autoriteti Kontraktues rezervon te drejtën e verifikimit te dëshmive te paraqitura ne ofertat e tyre.
Nëse Operatori ekonomik ka paraqitur te dhëna te rrejshme automatikisht do te eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do te konsiderohet si e papërgjegjshme
Çmimet e pjesëve duhet të jenë reale me tregun në të kundërtën konsiderohen si të papërgjegjshme.

☒ Çmimi më i ulët , i peshuar sipas Udhëzimit Administrativ 3/2015 të KRPP-së, të përcaktuar peshën sipas rregullës në vijim:

	Kategoritë	Pesha në bazë të rëndësisë		Çmimi I peshuar
1	Çmimi për servisim te rregullt,	50%	%	Çmimi x 50 %
2	Çmimi për Pjesët Mekanike	40%	%	Çmimi x 40%
3	Çmimi për Riparimi dhe ngjyrosja e pjesëve të Llamarinës, dhe pjesët tjera mekanike	10%	%	Çmimi x 10 %
		100%		

Operatorët ekonomik pjesëmarrës sipas raportit të hapjes publike të ofertave te datës 05.09.2016

B	Operatoret Ekonomik	Vendi	Llot	Çmimi në Euro
1.	"SFISHTA"	Prishtinë	I	25.886.18
			II	17.768.52
2.	"BESI"	Prishtinë	I	16,548.90
			II	7,439.80
3.	"SUZUKI	Fushë Kosovë	II	7.627.11
			II	5.496.43
4.	"BACI	Prishtinë	I	23.594.35
			II	

Vlerësimi i ofertave

Autoriteti Kontraktues në bazë të vendimit të OSHP-se të datës 22.12.2016 nr. 396/16 ka caktuar komisionin për ri vlerësim te ofertave në përbërje si ne vijim:

1. Zymer Kastrati-Kryetar
2. Genc Nuza –anëtar
3. Mehdi Uka – anëtar
4. Elizabeta Kamberi-Zyrtare ne Divizionin e Prokurimit -monitoruese

Komisioni vlerësues gjate rivlerësimit të ofertave e ka marr për baze vetëm ofertën e OE "Suzuki" dhe "Besi" me arsyetimin se ofertuesit tjerë pjesëmarrës nuk kane ofruar validitet te ofertave.

Sipas raportit të vlerësimit te dy operatoret e larte theksuar trajtohen te përgjegjshëm ne aspektin teknik ,administrativ dhe profesional dhe çmimet e tyre poentohen ne baze te ponetimit te përcaktuar ne dosje dhe ne njoftimit për kontrate por pa marre për baze numrin e automjeteve.

Sipas rezultateve finale për kontratë rekomandohet operatori ekonomik "Suzuki" për te dy Llotet pasi që për Lotin I çmimi i peshuar është 2.889.96 Euro dhe për Lot II 2,073.9 Euro

Ne procesverbal te vlerësimit theksohet se OE "Besi "rezulton te jete i përgjegjshëm por nuk rekomandohet pasi qe ofron çmim me t larte të peshuar.

Pas kërkesës për rishqyrtim te parashtruar pranë AK-se operatori ekonomik "Besi" me datë 31.01.2017 merr vendim për refuzim dhe sipas këtij vendimi pretendimet ankimore refuzohen si te pabazuara , përkatësisht oferta e tij konsiderohet e papërgjegjshme për faktin se në disa pozicione ka ofruar çmim zero (0.00) për dallim nga të gjithë fetusit tere.

Analiza dhe konstatimet e Ekspertit Shqyrtues (Neni 114 i LPP-së).

Duke pas për bazë pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Besi" dhe kërkesat e parashtruara ne dosje te tenderit Eksperti Shqyrtues ne përputhje me nenin 18 pika 2 te Rregullores se Punes së OSHP-se nr. 494/15 njofton Panelin Shqyrtues se kemi te bëjmë me pretendime ankimore te njëjta qe kane te bëjnë lidhur me nenin 59 te LPP-se, ndërsa pretendimi i ri ka te bej me nenin 61 te LPP-se lidhur me tenderët abnormalisht të ulet.

Pretimi ankimore lidhur me mos respektim te nenit 59 qëndron pasi eksperti konstaton se AK nuk ju ka përmbajtur këtij neni përkundrazi ka vlerësime kontradiktore ne mes raportit standard për rivlerësim, ku ne njërën ane OE."Besi" trajtohet i përgjegjshëm ne aspektin administrativ , teknik dhe financiar dhe njëkohësisht poentohet ne bazë të peshës se çmimeve çka do te thotë se sipas vlerësime te anëtareve te komisionit vlerësueses nuk kemi te bëjmë me oferte te papërgjegjshme , ndërsa ne ane tjetër ne vendim për rishqyrtim te ankesës OE "Besi" trajtohet i pa përgjegjshëm, pra kemi te bëjmë me vlerësim kundërthënës ne mes komisionit vlerësues dhe Zyrtarit te Larte te Prokurimit

Prove: Raporti i rivlerësimi dhe vendimi për rishqyrtim te kërkesës

Ne raportin standard ne asnjë pjese te tije nuk ceket se OE ankues ofron çmime me zero ashtu siç dhe theksohet ne vendimin për rishqyrtim sipas se cilit thuhet se ne disa pozicione çmimet janë ofruar me zero për dallim nga te gjithë ofertuesit tjerë, gjë qe për mendim te ekspertit çmimet e tilla konsiderohen të drejta për faktin se për pjesët te cilat nuk posedojnë automjetet çmimi duhet te jetë zero (0) siç është rasti për automjetet qe nuk posedojnë Tohograf, Bosh Pump apo pjese tjera pasi qe një numër i automjeteve janë dizel ndërsa një pjese janë benzine.

Eksperti konstaton se ne fund te pa pamasës dhe parallogaris përkatësisht pozicioneve te pjesëve shume qarte thuhet: "*ne rubrikat e çmimit për njësi te pjesët qe nuk janë te automjetit benzin ose dizel te shënohet me zero, ndërsa tek pozicionet tek sasia është zero edhe çmim shënohet me zero*"

Kjo tregon se AK listën e çmimeve për pjesë nuk e ka harmonizuar ne përputhje me natyrën e prokurimit për faktin se nuk mund të kërkohet çmim për pjesë qe nuk posedon automjeti, dhe nëse e shohim ofertën e OE te rekomanduar për kontratë tek automjetet qe nuk përmbajnë ato pjese ofrohet çmimi gjë qe sipas Eksperti detyrimisht çmimet e tilla nuk është dashur te marren për bazë , andaj për ekspertin është e pa qarte se si mund të ofrohet çmim për automjetet benzinë për BoshPump, për dizne si dhe pjese tjera qe nuk përmban automjeti apo ne te kundërtën për automjet dizel.

Eksperti konstaton se OE i rekomanduar për kontrate për sa i përket listës se çmimeve është i papërgjegjshëm dhe si i tille është dashur te trajtohet nga AK dhe listat e çmimeve e dorëzuar tek operatoret është dashur te harmonizohet me llojin e automjeteve dhe nuk mund te jete ndjesia një për pjesën qe nuk përmban automjeti dhe si i tille as qe mund te kërkohet çmimi

Gjithashtu ne vendimin për rivlerësim te lëshuar nga OSHP është kërkuar qe te behet poentomi i çmimeve dhe kjo përllogaritje duhet bere çmimet here sasia e automjeteve ne mënyrë qe te përmbushët parimi mbi efektivitetin dhe efikasitetin e shpenzimit te parëse publike .

Shkeljet eventuale te Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. në bazë pretendimeve ankimore.

Eksperti Shqyrtues pas ekzaminimit të procesit të prokurimit "MIREMBAJTJA DHE SERVISIMI I AUTOMJETEVE TË MKRS-së konstaton se gjate zbatimit te këtij aktiviteti te prokurimit, AK nuk ka respektuar nenet:

- Nenin 7 efikasiteti dhe efektiviteti i shpenzimit te parasë publike
- Neni 28 specifikat e automjeteve
- Nenin 59 vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Nenin 61 tenderët jo normalisht të ulet

Mendimi i Eksperti Shqyrtues

Eksperti Shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore janë te qëndrueshme dhe i rekomandon Autoritetit Kontraktues qe anuloj aktivitetin e prokurimit pasi qe lista e çmimeve nuk është e harmonizuar me kërkesat e AK-se.